



Datë: 17.07.2025
Numër Protokolli: 5325/2025

A.nr. 1045/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1045/2025, të datës 02.06.2025, të parashtruar nga ankuesi D.S, kundër organit të punësimit: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar A.nr.1045/2025, të datës 02.06.2025, të parashtruar nga ankuesi D.S.

II. Shfuqizohet Njoftimi i datës 29.05.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa **Anulohet** në tersi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 21.03.2025 me numër të Referencës RN00017154 për pozitën “ *Inspektor i Tokës Bujqësore*”, në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë.

III Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **III** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, D.S. (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 02.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr. 1045/2025, lidhur konkursin me numër referencës RN00017154, për Grupin i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, për pozitë, “*Inspektor i Tokës Bujqësore*”, Profesional 1, numri i kërkuar 5, pozita, me pretendimet ankimore kam aplikuar në konkursin e lartë cekur dhe se me pasi që jam nënshtruar testimit me shkrim kam arritur vetëm 44, pikë, me tej ankuesi pretendon se vlerësimi i esesë është bërë në mënyrë jo profesionale, pasi që eseja ka qenë rreth punës së inspektoreve për subvencione

dhe grande si mjet që përdoren gjatë punës, po ashtu ankuesi nga Këshilli ka pretenduar ta shqyrtojë ankesën pasi që vlerësimi i esesë behët sipas dëshirës së Komisionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 05.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 10.06.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova; Ankesën A.Nr. 3701/2025 të datës 02.06.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi me numër protokolli 3163, i datës 29.05.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidateve, i nxjerr nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i AZHB-së; Konkursi me numër referencë RN00017154, i datës 21.03.2025; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesin; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025, dërguar përmes emailit, nga R.K për M.B; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1042/2025, e datës 11.06.2025; Vendimi me numër protokolli 2780, i datës 06.05.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimit, i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i AZHB-së; Akt Emërimi i datës 12.01.2017, për I.XH; Vendimi me numër protokolli 1800, i datës 18.03.2025, për I.H; Akt Emërimi i datës 12.01.2017, për Q.M; Vendimi me numër protokolli 1801, i datës 18.03.2025, për Q.M; Akt Emërimi i datës 30.08.2022, për B.M; Vendimi me numër protokolli 1392, i datës 28.02.2025, për B.M; Akt Emërimi i datës 30.03.2023, për M.B; Vendimi me numër protokolli 7380, i datës 17.09.2024, për M.B; Akt Emërimi i datës 12.01.2017, për XH.H; Lista e Aplikantëve; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN0006; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN9261; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN2043; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN0894; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN4810; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN8895; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN0261; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN1004; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN8644; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN4146; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN2618; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN2866; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN9456; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN1865; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN1866; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN5294; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN6623; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN9674; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN1207; Formulari

për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN1282; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN5460; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN1244; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN5624; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN5355; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN1136; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 27.05.2025, sipas kodit CN5690; Aplikacioni i D.S, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 205, e datës 17.01.2013, për D.S e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Diplomë me numër protokolli 115, e datës , për D.S e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina”; Certifikatat e D.S; Vërtetim i dates 10.08.2015; Vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 08.12.2015, për D.S; Pasqyra e trustit për D.S, për periudhën nga data 16.05.2017, deri me datë 05.03.2025; Deklaratë për D.S; Aplikacioni i A.G, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 2 , e datës 18.11.2015, për A.G e lëshuar nga Universiteti “Haxhi Zeka”, në Pejë; Diplomë me numër protokolli 64 , e datës 23.08.2019, për A.G e lëshuar nga Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletni; Vërtetim i datës 19.04.2025, për A.G; Ankesë kantatat e dates 21.03.2021, për A.G; Vendimi i datës 05.11.2021; Kopje e letërnjoftimit për A.G; Kontrata e punës për punë të caktuar e datës 29.11.2022, për A.G; Vendimi i datës 31.10.2022; Kontrata e punës e datës 07.12.2023, për A.G; Vërtetim i datës 27.010.2023; Pasqyra e trustit për A.G, për periudhën nga data 01.08.2002, deri me datë 21.03.2025; Kontrata e datës 17.10.2023; Aplikacioni i N.N, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 861, e datës 26.08.2018, për N.N e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina”; Diplomë me numër protokolli 354, e datës 29.06.2021, për N.N e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “ Hasan Prishtina”; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin N.S, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin E.S, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin L.M, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin Z.K, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin N.N, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin E.M, nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin F.H, nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin N.S, nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin N.N, nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin E.S, nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin Z.K nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin L.M, nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin A.G, nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin M.K, nga anëtari i komisionit I.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për

kandidatin M.K, nga anëtari i komisionit Xh.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin Z.K, nga anëtari i komisionit Xh.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin F.H, nga anëtari i komisionit Xh.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin M.S, nga anëtari i komisionit Xh.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin E.S, nga anëtari i komisionit Xh.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin A.G, nga anëtari i komisionit Xh.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin E.M, nga anëtari i komisionit Xh.H; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin M.K, nga anëtari i komisionit B.K.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin A.G, nga anëtari i komisionit B.K.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin Z.K, nga anëtari i komisionit B.K.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin E.S, nga anëtari i komisionit B.K.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin N.N, nga anëtari i komisionit B.K.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin N.S, nga anëtari i komisionit B.K.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin F.H, nga anëtari i komisionit B.K.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin L.M, nga anëtari i komisionit B.K.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin F.H, nga anëtari i komisionit M.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin N.S, nga anëtari i komisionit M.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin N. S, nga anëtari i komisionit M.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin Z.K, nga anëtari i komisionit M.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin L.M, nga anëtari i komisionit M.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin A.G, nga anëtari i komisionit M.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin E.M, nga anëtari i komisionit M.B; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin M.K, nga anëtari i komisionit M.B; Vendimi me numër protokolli 2780, i datës 06.05.2025, për themelimin e Komisionit të Pranimi i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i AZHB-së; Rezultati i testimit me shkrim i datës 27.05.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Njoftimi me numër protokolli 2163, i datës 29.05.2025, për kandidatet fitues; Diplomë me numër protokolli 723, e datës 18.10.2017, për N.S e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Diplomë, e datës 29.03.2023, për N.S e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Certifikatat për N.S; Vërtetim për N.S; Kontratë e punës e dates 03.01.2022; Pasqyra e trustit për N.S, per periudhën nga data 01.08.2022, deri me datën 14.04.2025; Vërtetim i dates 05.02.2023; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin M.K, nga anëtari i komisionit Q.M; Vërtetim i dates 23.08.2024; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin F.H, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në

Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin A.G, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 29.05.2025, për kandidatin E.M, nga anëtari i komisionit Q.M; Vërtetim i datës 08.07.2020, për N.N; Vërtetim i datës 15.07.2023, për N.N; Vërtetim i datës 20.11.2024, për N.N; Formulari i Vlerësimit të rezultateve në Punë; Aplikacioni i L.M, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 75, e datës 11.10.2010, për L.M, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatat për L.M; Vërtetimi i datës 24.02.2023, për L.M; Vërtetimi i datës 11.08.2023, për L.M; Vërtetimi i datës 08.08.2023, për L.M; Formulari i Vlerësimit të rezultateve në Punë për L.M; Referencë punë e datës 22.02.2024; Referencë punë e datës 06.07.2020; Kopje e letërnjoftimit për L.M; Vërtetimi i datës 25.03.2025, për L.M; Pasqyra e trustit për L.M, për periudhën nga data 01.08.2022, deri me datën 14.04.2025; Aplikacioni i E.S me shkresat e bashkangjitura; ;Diplomë me numër protokolli 367/45-64, e datës 17.05.2021, për E.S, e lëshuar nga Kolegji i Ilira; Diplomë me numër protokolli 97/45-56, e datës 24.01.2025, për E.S, e lëshuar nga Kolegji i Ilira; Certifikatat për E.S; Kontrata e punës e datës 01.10.2022, për E.S; Pasqyra e trustit për E.S, për periudhën nga data 26.06.2023, deri me datën 26.03.2025; Kontrata e punës e datës 29.03.2024, për E.S; Referencë e datës 07.04.2022; Aplikacioni i N.S.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë m datë 21.03.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00017154, për Grup i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, pozita “*Inspektor i Tokës Bujqësore*” *klasa e pozitës Profesional I*”, numri i kërkuar 5, ku afati për aplikim ka qenë nga data 22.03.2025 deri më 20.04.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në konkurs ka aplikuar dhe ankuesi.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me datë 29.05.2025, me numër 3163, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatet fituese, nga i cili njoftim rezulton se kandidati L.M, është vlerësuar me gjithsejtë 98, pikë, kandidati N.N, është vlerësuar me gjithsejtë 98, pikë, kandidatja N.S, është vlerësuar me gjithsejtë 96.8, pikë, kandidatja E.S, është vlerësuar me gjithsejtë 93.6, pikë, dhe kandidati A.G, është vlerësuar me gjithsejtë 92.2, pikë.

Ankuesi D.S, i pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 29.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore sikur janë shënuar në hyrje të këtij arsyetimi.

Kolegji i Këshillit, fillimisht konstaton së Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me datën 21.03.2025, ka publikuar konkursin me Nr. reference RN00017154, për **Grupi i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës** pozita “ *Inspektor i Tokës Bujqësore*, për të cilën pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); Fakulteti i Bujqësisë. Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku dy (2) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*”. Bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së kriteret e konkursit për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësore, të publikuara nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, janë përcaktuara në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, numri rendor 30 ku përcaktohet se: “30. Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës, Gjeografi, Veterinari, si dhe në

kundërshtim me *Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil*, sipas numrit rendor 89, ku përcaktohet se; 89 *Inspektor i tokës bujqësore SHC-0089 Profesional 1 Grupi i bujqësisë, pyjeve dhe tokës Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës, Gjeografi, Veterinari*.

Kolegji i Këshillit përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit, mori për bazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës 1 të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës 6 të dispozitivit të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua fakti se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 21.03.2025.

Në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e aplikuara të nenit 19, si dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: “19. *Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi; 30.1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 30.2. **Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.**”, konstatoi se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, shpalljen e konkursit RN00017154 të datës 21.03.2025 për pozitën “Inspektor i Tokës Bujqësore” e ka shpallur në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar dhe i cili ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024 sipas Vendimit Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojcën Nr.2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, pasi që për pozitë në fjalë Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, si kritere ka përcaktuar Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); Fakulteti i Bujqësisë, ndërsa sipas Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si kritere janë të përcaktuar për . Grupin e Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, janë të përcaktuara si në vijim; *Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës, Gjeografi, Veterinari*, si dhe në kundërshtim me Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, e po ashtu edhe sipas Katalogut të vendeve të punës, kriteret janë të parapara si në vijim, për Grupin e Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës, Agronomi/ Pylltari/Hortikulturë/Shkencat e Tokës, Gjeografi, Veterinari, dhe për rrjedhojë pozitës në fjalë i janë ndryshuar edhe kriteret e përcaktuara të kualifikimit arsimor të cilat janë të përcaktuara sipas rregullores së lartcekur dhe Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, nga rrjedh se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me nenin 19 dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në këtë procedurë të rekrutimit shkeljet janë evidentuar qysh me rastin e shpalljes së konkursit të datës 21.03.2025 ashtu që nuk janë përfillur kriteret e aprovuara lidhur me grupimin e pozitës, duke ndryshuar më pastaj edhe kriteret për fushën e kualifikimit arsimor për pozitën “ *Inspektor i Tokës Bujqësore*”, duke u bazuar në dispozitat e nenit 53 dhe nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit

Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi që të anuloi konkursin e datës 21.03.2025 me numër të Referencës RN00017154 Grupi i Bujqësisë Pyjeve dhe Tokës, pozita “Inspektor i Tokës Bujqësorë”, në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë si dhe të shfuqizoi çdo akt dhe veprim tjetër procedural që ndërlidhet me konkursin në fjalë.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se meqenëse konstatoi paligjshmërinë e aktit të shpalljes së konkursit në fjalë, nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesën e datës 02.06.2025, pasi që konstatimi nëse pretendimet janë apo jo të bazuara nuk do ta ndryshonin natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar vetëm për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 dhe nenit 24 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, ku përcaktohet se: “21.1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës; 24.1. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.”, në rast se Vendimi i Këshillit nuk zbatohet sipas dispozitivit të përcaktuar, ndaj personit përgjegjës i përcaktuar në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, do të merren masa përkatëse në pajtim me nenin 24 paragrafi 1 të njëjtë ligji.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 1045/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, D.S;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së